



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
QENDRA E SHERBIMEVE ARSIMORE

Nr. 4958 Prot.

Tiranë, më 01.11, 2022

**Shpallje e kërkesës për hartues të fondit të pyetjeve të testimit të informatizuar për maturantët, në kuadër të pranimit në programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë**

Qendra e Shërbimeve Arsimore shpall kërkesën për hartues të fondit të pyetjeve të testimit të informatizuar për maturantët, në kuadër të pranimit në programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

Shpallja e kërkesës është e hapur për të gjithë të interesuarit që ushtrojnë profesionin e mësuesit, si në institucionet publike, edhe në ato private.

Kandidatët e interesuar, përpara se të fillojnë përgatitjen e dokumenteve për aplikim, duhet të sigurohen që i plotësojnë kriteret e shpallura për t’u përzgjedhur.

1. I interesuari për hartues të fondit të pyetjeve të testimit të informatizuar plotëson kriteret si vijon:

- a) ushtron profesionin e mësuesit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi;
- b) ka të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë pune si mësues në arsimin e mesëm të lartë;
- c) ka dhënë lëndën përkatëse të paktën 1 (një) herë në të gjitha klasat e arsimit të mesëm të lartë;
- d) ka të paktën kategorinë e kualifikimit “mësues i kualifikuar” dhe është vlerësuar në provimin e kualifikimit të mësuesve me “Shumë mirë”.
- e) preferohet të ketë përvojë në hartimin e pyetjeve për provimet kombëtare.

2. Të interesuarit dorëzojnë dokumentacionin e aplikimit si më poshtë:

- a) CV sipas modelit Europass;
- b) fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm;
- c) vërtetim nga ZVAP që ka të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë pune si mësues, në shkollat e mesme.
- d) fotokopje të dokumentit që provon zotërimin e kategorisë së kualifikimit;
- e) vërtetim nga drejtuesi i institucionit arsimor që kandidati ka dhënë lëndën përkatëse të paktën 1 (një) herë në të gjitha klasat e arsimit të mesëm të lartë.
- f) certifikatë si hartues pyetjesh nga QSHA (nëse ka).

### **Procedura e aplikimit**

Qendra e Shërbimeve Arsimore do të pranojë vetëm aplikime që do të dërgohen me postë në QSHA. Nuk pranohen aplikime dorazi.

### **Afati i dorëzimit të aplikimeve dhe procedura e vlerësimit**

Aplikimet do të drejtohen pranë QSHA, **duke filluar nga data 01.11.2022 deri më 07.11.2022.**

Dokumentet e nevojshme që kandidati i interesuar duhet të dorëzojë, dhe mënyra e aplikimit përcaktohet si më poshtë. Të dhënat e kandidatëve do të grumbullohen duke respektuar Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

**Aurora BALLIU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

